REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr.1754/1 Prot Tiranë, më 27/07/2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE_____

DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit professional", Urdhërit nr.172, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" dhe shkresës nr.293/1 prot, datë 15.07.2020 "Njoftim për vende të lira pune" të Shkollës së Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier, protokolluar në AKPA me nr.1773/6 prot, datë 20.07.2020,

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të lëvizjes paralele për personelin mësimdhënës të kulturës profesionale, në Shkollën e Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier, për pozicionet:

a) 1 Inxhinier elektrik
b) 2 Inxhinier mekanik
c) 1 Inxhinier hidro

1. **Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier**

Aplikanti për mësimdhënës të kulturës profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier,duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale në Shkollën e Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier si vijon:

a) të ketë diplomë nga një institucion i arsimit të lartët të nivelit master i profesionit ose master i shkencave ose të barasvlershme, për një nga profilet që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të AFP-së;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Shkollës së Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 27.07.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Shkolla e Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionet:

d) 1 Inxhinier elektrik
e) 2 Inxhinier mekanik
f) 1 Inxhinier hidro

në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional".

Shkolla e Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Fier, në faqen elektronike zyrtare të Shkollës së Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier , si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Shkollës së Mesme Profesionale "Petro Sota" Fier.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Elira DEMIRAJ